



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 34, datë 28.05.2015

MBI

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR RAPORTIMIN E DETYRUAR DHE
PERIODIK TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikat 2 dhe 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 111, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores “Për raportimin e detyruar dhe periodik të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit”, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI